



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 3267 prot.

Himarë, më 07.07.2022

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, Bashkia Himarë, njofton shpalljen për:

- 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin: Inspektor i IMT-së, në inspektoriatin e mbrojtjes së territorit, në Bashkia Himarë.**

PËRSHKRIMI PËRSGJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN SI MË SIPËR ËSHTË:

- Ushtron funksionet ligjore për mbrojtjen e territorit, brenda kufijve administrative të Bashkisë Himarë;
- Ushtron kontroll në territorin e Bashkisë, veçanërisht te subjektet e ndërtimit, sipas planit të miratuar më parë nga kryeinspektori;
- Pasqyron veprimtarinë e punës në procesverbalin e konstatimit, të cilin ia dorëzon kryeinspektorit;
- Merr pjesë në ekzekutimin e vendimeve për prishje të objekteve të paligjshme brenda territorit të bashkisë;
- Ndjek dhe zbaton urdhërat dhe detyrat e dhëna nga kryeinspektori gjatë ushtrimit të kontrolleve;
- Dokumenton punën e bërë në ushtrimin e detyrës me aktet proceduriale të miratuara;
- Administron sipas ligjit dokumentacionin e depozituar nga subjektet fizike e juridike pranë IMT-së.

KËRKESAT E PËRSGJITSHME PËR KANDIDATËT:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

KANDIDATËT DUHET TË PLOTËSOJNË KRITERET E VEÇANTA SI VIJON:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” ose “Master Shkencor apo Profesional”, në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.
- b) Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e tjera, në profesion.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për aplikim;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumente/219-udhezime-dokumente>
- c- Fotokopje të diplomës dhe lista e notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Certifikatë familjare;
- g- Certifika personale;
- h- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- i- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- j- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- k- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, brenda datës 27.07.2022.

BASHKIA HIMARË

Drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse

